

PAVLI HAXHILAZI

VËZHGIME MBI MBIEMRAT FOLJORË ME PRAPASHTESËN -SHËM NË GJUHËN SHQIPE

Nga pikëpamja semantiko-strukture mbiemrat e formuar me prapashtesën -shëm nuk janë studjuar në mënyrë të veçantë. Megjithatë këta mbiemra nuk kanë mbetur pa u trajtuar fare. Gjuhëtarët në vëzhgimet për pjesët e ndryshme të ligjëratës i kanë parë këto formime kryesisht nga ana strukture, duke përcaktuar prapashtesën -shëm si një formant prodhues për formimin e kategorisë së mbiemrave. Zhvillimi i kësaj kategorie në gjuhën e sotme letrare shqipe ka rritur edhe ka ndryshuar shkallën e prodhimit (produktivitetit) së morfemave që formojnë mbiemra, ka specializuar dhe kuptimet e tyre. Në gjendjen e sotme prapashtesa -shëm numërohet ndër prapashtesat kryesore që formojnë mbiemra.

Vëzhgimet e para për formimet mbiemërore në -shëm i gjejmë në për manuale e tekste shkollore. Së pari këto i ka dhënë S. Frashëri¹, duke shënuar trajtat fonetike dialektore -shm, -shim, -çim, si prapashtesa që formojnë mbiemra nga ndajfoljet e kohës e të vendit dhe nga emrat. Nga shembujt e dhënë trajta -çim formon mbiemra vetëm nga emrat, kurse trajtat -shm e -shim vetëm nga ndajfoljet.

Anton M. Xanoni² jep trajtën -shëm për gjininë mashkullore, e cila në femërore bën -shme. Për herë të parë në gramatikën e tij pasqyrohen formimet mbiemërore në -shëm nga temat foljore.

G. Vajgandi³ vë re se formimet në -shëm bëhen gjithnjë e më të shpeshta nga temat e pjesoreve të foljeve, të ndajfoljeve dhe të emrave. Në gramatikën e tij jepet vetëm trajta -shëm, e cila sot në gjuhën letrare shqipe ka zënë vend, duke mënjanuar variantet e tjera fonetike dialektore.

G.M.⁴ jep variantet -shem e -çem. Për mbiemrat që formohen prej ndajfoljeve të kohës e të vendit si edhe prej emrave, autori shënon si mjet fjalëformues prapashtesën dhe nyjen e përparme si element përbërës.

O. Myderrizi⁵ ka sjellë shembuj «mbiennash të përngjitur». Në to autori fut formimet prefiksalo-sufiksale (si *i përjavëshëm*, *i përditëshëm*), prejardhjet (derivimet) parashtesore (si *i pabesueshëm*), dhe formimet që kanë në përbërjen e tyre edhe një numëror (si *i përdymuejshëm*, *i përdyjavëshëm*).

K. Cipo⁶ jep shembuj që kanë jo vetëm prapashtesën -shëm, por

1) S.H. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Bukuresht 1886, f. 37.

2) A.M. Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër 1909, f. 51.

3) G. Weigand, *Albanesische Grammatik*, Leipzig 1913, f. 54.

4) G.M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Shkodër 1916, f. 35, 37.

5) Osman Myderrizi, *Gramatika e Re e shqipes*, Tiranë 1944, f. 78-80.

6) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë 1949, f. 73, 77-78.

edhe trajtat *-çmë*, *-shmë*. Autori jep formime mbiemërore, që kanë në temën e tyre prodhuese vetëm emra dhe ndajfolje kohe e vendi.

Sh. Demiraj⁷ e shikon prapashtesën *-shëm* si më prodhuesen midis prapashtesave të tjera që formojnë mbiemra në shqipen e sotme.

Nga ana semantike vëzhgimet e para për formimet mbiemërore në *-shëm* i ka dhënë G. Vajgandi, kur thotë që formimet në *-shëm* «mund të kenë jo vetëm kuptim pësor, por edhe vepror»⁸.

Një zbërthim të kuptimit të një pakice mbiemrash foljorë me prapashtesën *-shëm* bën I.D. Sheperi: «Mbiemrat foljorë marrin prapashtrimin *-shëm* (ose *-ëm*) dhe tregojnë atë që mund ose meriton të pësojë. P.sh. *i nderueshëm* = ay që meriton të nderohet; *i shkrueshëm* = ay që mund të shkruhet; *i pëlqyeshëm* = ay që mund ose meriton të pëlqehet; *i mër-zitëshëm*, *i çmueshëm*, *i ardhëm*, *i pritëm* etj.»⁹.

Edhe O. Myderrizi në «Gramatikën...» e tij shënon se «në mbiemnat e prejardhun prej pjesorësh mbrapashtesa *-shëm* tregon mundësi a meritim: *i falshëm* — njeri që mund të falet për ndonjë gabim që ka bërë; *i nderueshëm* — njeri që meriton të nderohet»¹⁰.

Këto vëzhgime, natyrisht, mbeten të përgjithshme, sespe nga njëra anë, autorët nuk kanë pasur si qëllim në vetvete analizën e këtyre formimeve dhe nga ana tjetër, vetë tekstet kanë qenë të përcaktuara për nxënësit e shkollave ose për një njohje të përgjithshme të veçorive gramatikore të gjuhës shqipe.

Në mënyrë të veçantë formimet me prapashtesën *-shëm* janë parë nga A. Xhuvani dhe E. Çabej¹¹. Këto vëzhgime, që ruajnë karakterin e tyre përgjithësisht parashtrues (ekspozitiv), kanë pasqyruar disa përfundime të analizës strukturo-semantike të formimeve me prapashtesën *-shëm*.

Ndarje më të hollësishme nga ana semantike ka bërë A. Kostallari¹², duke shënuar se mbiemrat foljorë në *-shëm* i karakterizojnë sendet nga aftësia ose paaftësia, mundësia ose pamundësia dhe pashmangshmëria për t'ju nënshtruar një veprimi të caktuar ose për të shprehur një gjendje, një kryerje të veprimit.

Si objekt të këtij punimi nuk do të jenë të gjitha njësitë leksikore, që kanë në përbërjen e tyre prapashtesën *-shëm*, por vetëm mbiemrat. Por edhe formimet mbiemërore i kemi ndarë nga pikëpamja strukturore në dy grupe kryesore: 1 — Mbiemrat foljorë me prapashtesën *-shëm*, d.m.th. të gjithë ata mbiemra, të cilët kanë në përbërjen e temës së tyre prodhuese një temë foljore, temën e pjesores. 2 — Mbiemrat jofoljorë me prapashtesën *-shëm*, d.m.th. të gjithë ata mbiemra, të cilët nuk kanë në përbërjen e temës së tyre prodhuese një temë foljore, por një kategori tjetër leksiko-gramatikore. Këtu do të përfshihen temat emërore e ndajfoljore. Nga këto dy grupe në këtë punim do të paraqisim disa vëzhgime vetëm për grupin e parë.

Përpara se të kalojmë në analizën semantike të këtij grupi duhet sqaruar kjo çështje themelore: Cila temë foljore përbën temën prodhuese të këtyre mbiemrave? Faktet gjuhësore të shqipes së sotme letrare

7) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, pjesa I, (dispensë), prill 1960, f. 83; *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë 1964, f. 97-98.

8) G. Weigand, *Albanesische Grammatik*, Leipzig 1913, f. 54.

9) I.D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë 1927, f. 136.

10) O. Myderrizi, *Gramatika e Re e shqipes*, Tiranë 1944, f. 79.

11) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962, f. 84-86.

12) A. Kostallari, *Formimi i fjalëve në gjuhën shqipe*, kurs special leksionesh, mbajtur në vitin akademik 1960-61, në Fakultetin e historisë e të filologjisë të USHT.

pohojnë se si temë prodhuese e mbiemrave foljorë në *-shëm* është tema e pjesores së foljes. Duke e parë çështjen e mësipërme për gjuhën shqipe A. Xhuvani dhe E. Çabej kanë dhënë përfundimet se mbiemrat që vijnë prej foljesh formohen kryesisht prej temës së pjesores dhe fort rrallë prej temës së të tashmes. Por kur thonë se «Në pjesën më të madhe të fjalëve me këtë prapashtesë ndërkaq, në ndjenjën gjuhësore të sotmen pikënisje është tema e përgjithshme e foljes, që nuk mund të thuhet se është e prezentit. Aty hyjnë rasta të tilla si *i bëshëm i bëshëm, i dhimbshëm, i këndshëm, i kândshëm, i lodhshëm, i mërzitshëm, i nguçëm, i përdorshëm, i pishëm, i trembshëm*»¹³ problemi nuk gjen zgjidhje të drejtë. Duke gjykuar për shembujt e dhënë nuk kemi në ta një «temë të përgjithshme të foljes, që nuk mund të thuhet se është e prezentit», por, përkundrazi, kemi temën e pjesores së foljes. Nga këta shembuj ne veçojmë mbiemrin *i këndshëm, i kândshëm*, që është formuar jo nga tema foljore, por nga përngjitja e togut folje + emër: *ka ënda, ka anda* > *i këndshëm, i kândshëm*. Ndonjë mbiemër si *i dishëm*, që sillet si rast fort i rrallë, i cili formohet nga tema e formës së kohës së tashme, është fakt dialektor dhe, si i tillë, s'ka gjetur vend në sistemin leksikor të gjuhës së sotme letrare shqipe. Ky kuptim i këtij formimi shprehet me mbiemrat pjesorë, d.m.th. me *i ditur*. Tema e pjesores që del në përbërjen e temave prodhuese tek mbiemrat foljorë në *-shëm*, nuk është forma e plotë e trajtës së pjesores që ka hyrë në sistemin e gjuhës së sotme letrare shqipe. Ajo paraqitet në temën fjalëformuese si një pjesore e shkurtuar e mbarë shqipes. Për foljet që kanë prapashtesat *-o, -ro, -so, -to, -zo*, etj., d.m.th. për foljet që dalin në temën e tyre me zanore, kjo pjesore ka formën e gegërishtes dhe është futur e bërë pjesë përbërëse në strukturën fjalëformuese të shqipes së sotme letrare. Ndër veçoritë kryesore të strukturës fonetike të shqipes së sotme letrare është edhe thyerja e kundërvënjes (opozicionit) dialektore midis dyzanoreve *ua-ue* ku «si njeri ashtu edhe tjetri bëjnë pjesë tashti në strukturën fonetike të atij që është quajtur «variant letrar kryesor»; diftongu *ue* tashmë ka fituar epërsinë, në mos zotërimin e plotë, në mbiemrat foljorë në *-shëm* e në formimin e nomina agentis nga tema e pjesores (*i lundrueshëm; mësuës*)»¹⁴. Në gjuhën e shkruar nuk kanë munguar rastet që mbiemrat foljorë të kenë në përbërjen e temës së tyre prodhuese temën e pjesores me *-uar* si *i ndryshuarshëm, i pandryshuarshëm, i paqëndruarshëm* etj. të cilat, jo vetëm nuk kanë gjetur shtrirje, por përkundrazi, kanë shkuar drejt mënjanimi të tyre të plotë nga shqipja e sotme letrare.

Pse pjesorja është e vetmja formë e pranueshme në gjuhë për formimin e mbiemrave foljorë në *-shëm*? Përgjigjen për këtë pyetje duhet ta kërkojmë tek vetë përmbajtja dhe funksionet që ka pjesorja në gjuhën shqipe.

Përmbajtjen dhe funksionet e pjesores në gjuhën shqipe, në një mënyrë të përmblodhur, i ka dhënë A. Kostallari. Duke qenë se këto janë rezultate të reja në këtë fushë po i citojmë gjerësisht: «...pjesorja... jo vetëm bashkëbart të dyja funksionet, — foljore e mbiemërore — por si e vetmja trajtë me të vërtetë e pashtjelluar foljore (ose trajtë foljore e pashtjelluar e mirëfilltë) mund të shtjellohet në vetëdijen e folësit në trajta e mënyra të ndryshme dhe në plane të ndryshme kohore — të së

13) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962, f. 85.

14) Shih: A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, në «Shkencat shoqërore në shkollë», Tiranë 1967, f. 67.

kaluarës, të së tashmes e të së ardhshmes. Në gjuhën tonë pjesorja nuk ka të përcaktuar as modalitetin (mënyrën), as numrin e vetën, e bile, e marrë në vetvete, i ka mjaft amorfe e të paqarta edhe kategoritë e kohës e të diatezës. Me një përmbajtje kaq të gjerë e elastike, pjesorja i lë kështu vetëdijes gjuhësore të folësit të shqipes mundësi të shumta realizimi»¹⁵.

Pjesorja, duke u kualitativuar, «shtjellohet», zbërthehet jo vetëm në mbiemrat pjesorë, por edhe në mbiemrat foljorë me prapashtesën *-shëm*, ku duke qenë temë fjalëformuese e tyre, mund të ketë kuptim kalimtar vepror a pësor dhe kuptim jokalimtar. Mbiemrat *i çuditshëm*, *i ndieshëm*, *i pandieshëm*, *i durueshëm* janë formuar nga pjesoret e foljeve me kuptim kalimtar të diatezës veprorë. P.sh.: «Nuk shkoi as në meshë dhe as që dëshironte të shikonte *çiftin e çuditshëm*» [P. Marko, «Qyteti i fundit», 1960, f. 207]; «Po, por kjo është kopja. Do ta shkruaj edhe një herë: ...Sa njeri *i çuditshëm* që je!... Mos kujtove se do ta paraqitja kështu?» [KLSH*]; «Atomet janë trupa të *pandieshëm*. Ndieshmëria vjen nga lëvizja e atomeve që radhiten në mënyrë të tillë sa që arrijnë të formojnë sendet e *ndieshme* (sensilia)» [KLSH]; «Megjithëse ishte *ndjeshëm* sa s'bëhej, ai shumë herë arrinte të bëhej melodramatik, por atëherë ishte i singertë dhe nuk e bënte për t'u dukur». [KLSH]; «Si farë është përdorur ajo e llojit «Star», e cila është mjaft *e durueshme*, si ndaj thatësirës, ashtu edhe ndaj lagështisë». [«Zëri i popullit» 8.I.1966, f. 6]; «Ndërtimi i stivave ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së duhanit, shtimin e qëndrueshmërisë së tij për një konservim më të mirë e më të *durueshëm* (rezistent) kundrejt dëmeve të ndryshme, në depo», [R. Cami, «Vjelja, tharja dhe manipulimi i duhanit», f. 23].

Mbiemrat *i durueshëm*, *i kultivueshëm*, *i mbjellshëm*, *i pagueshëm* janë formuar nga pjesoret e foljeve me kuptim kalimtar të diatezës pësore. P.sh.: «Guderiani u kthye në kohën më fatkeqe por me gjithë këtë në muajt e parë të këthimit të tij raportet e tij me Hitlerin ishin deri diku të *durueshme* gjer në shtator të vitit 1944 kur u çfaqën mosmarrëveshje të reja» [KLSH]; «...në afërsi të stallave lihet për kullotë të *kultivueshme* 1 hektar tokë për 10-40 dosa» [P. Papazisi — J. Keçi, «Rritja e derrit», Tiranë 1966, f. 85]; «Në fillim ne kishim vetëm 314 ha tokë të *mbjellëshme*» [«Zëri i popullit», 13.I.1966, f. 3]; «Punëtori ose nëpunësi që vazhdon shkollën e natës ose me korespondencë, ka të drejtë për një leje vjetore të *pagueshme*, kohëzgjatja e së cilës caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave» [Gaz. «Puna», 20.9.1966, f. 3].

Mbiemrat *i lëkundshëm*, *i pajtueshëm*, *i vajtueshëm*, *i dridhshëm* janë formuar nga pjesoret e foljeve vetvetore mesore. P.sh. «...ka raste jo të rralla që nxënësi ka të drejtë të tregohet *i lëkundshëm*» [Gaz. «Mësuesi» 20.11.1964, f. 2]; «...çështja e Vietnamit ka vetëm një zgjidhje të *pajtueshme* me marrëveshjet e Gjenevës të vitit 1954 dhe që përfshihet në katër pikat e propozuara nga Republika Demokratike e Vietnamit.» [«Zëri i popullit», 3.2.1966, f. 1]; «Rezultatet janë me të vërtetë të *vajtueshme*» [«Zëri i popullit», 10.12.1965, f. 3]; «M'i tregoi jotë motër — e ndërpreu ajo me zë të *dridhshëm*» [Fatmir Gjata, «Në pragun e jetës», 1960, f. 21].

Mbiemrat *i luejtshëm*, *i qëndrueshëm* janë formuar nga pjesoret e foljeve me kuptim jokalimtar p.sh. «Mbajtësi i stapit të zi kishte në karrocën

15) A. Kostallari, *Kompozitat urdhërore e dëshirore të shqipes*, «Studime filologjike», 4. 1968, f. 38.

*) Shkurtim, që do të thotë se shembulli është nxjerrë nga kartoteka e leksikut të shqipes, pranë Institutit të historisë e të gjuhësisë.

e tij mbi një fron të *luajtshëm*, një jastëk prej pëlhure të qëndisur me argjend,...» [Viktor Hygo, «Njeriu që qesh», II, Përkth. Bujar Doko, Tiranë 1967, f. 222]; «...lidhja e gjerë, e thellë dhe e qëndrueshme me masat punonjëse nuk mund të jetë kurrë një diçka e sipërfaqëshme dhe nuk mund të krijohet vetëm me takime zyrtare ose sa për të qenë prezent» [E. Hoxha, «Të zbatojmë me këmbëngulje e në mënyrë krijuese detyrat për revolucionarizimin e partisë e të jetës së vendit», Tiranë 1968, f. 23-24];

Mbiemrat në këta shembuj shënojnë tiparin e aftësisë së kryerjes së një veprimi* ose tiparin e aftësisë a të mundësisë për t'ju nënshtruar një veprimi të caktuar. Në rastet e prejardhjeve (derivimeve) me prapashtesën *pa-* tipari i aftësisë a i mundësisë që shpreh mbiemri mohohet.

Gjatë analizës semantike të mbiemrave foljorë në *-shëm* do të ndalemi në dy çështje kryesore:

1) Kuptimi i tyre.

2) Diferencimet kuptimore që kanë ndodhur në gjuhën e sotme letrare shqipe, shtrirja e kuptimeve dhe e nuancave kuptimore dialektore të këtyre formimeve në formimet e ngjashme të shqipes së sotme letrare.

Meqenëse kuptimi i mbiemrave foljorë është i varur nga kuptimi i foljes, kuptimi i së cilës ruhet në temën prodhuese të mbiemrit, dhe lidhet me të, analiza semantike e formimeve foljore mbiemërore në *-shëm* do të bëhet duke pasur si mbështetje kryesore këtë kriter. Përdorimi i këtij kriteri ka edhe karakter thjesht metodik për shqyrtimin e materialit.

Në bazë të lidhjes, që ekziston ose jo, ndërmjet kuptimit të mbiemrit foljor në *-shëm*, dhe kuptimit të foljes që përbën temën prodhuese të mbiemrit, kemi:

1) *Grupi i mbiemrave, që e ruajnë lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes përkatëse*. Në bazë të kësaj lidhjeje përcaktohet përmbajtja e tiparit që shënon mbiemri. Edhe zbërthimi i kuptimit të mbiemrit, d.m.th. shpjegimi i tij në një fjalor shpjegues, do të bëhet në bazë të kësaj lidhjeje.

Tipari që shënon mbiemri, mund të ketë lidhje vetëm me një kuptim të caktuar të foljes, e cila përbën temën prodhuese të tij. Kështu ky kuptim mund të jetë ose kuptimi kryesor i foljes, ose një kuptim i prejardhur a figurativ i saj. Për të përcaktuar kuptimin e mbiemrit dhe lidhjen e tij me një kuptim të caktuar të foljes përkatëse, duhet parë çdo fakt gjuhësor, sepse, duke qartësuar këto lidhje, mund të përcaktojmë drejt edhe kuptimet leksikore. P.sh. po analizojmë tri kuptime që ka mbiemri *i lëvizshëm*.

Në togun: *karrike e lëvizshme* kemi lidhjen e kuptimit të mbiemrit me kuptimin kryesor të foljes dhe shpjegimi, zbërthimi i kuptimit të tij bëhet duke përdorur këtë folje në kuptimin e parë: që *lëviz* ku *lëviz* është folje jokalmtare me kuptimin *luaj vendit*¹⁶.

Në togun *djalë i lëvizshëm* kemi lidhjen me kuptimin e prejardhur të foljes *lëviz*: lëviz me tepër se ç'duhet. Ky është një kuptim i prejardhur, që në strukturën kuptimore të foljes «Fjalori i gjuhës shqipe» i vitit 1954 nuk e shënon fare. Edhe ne nuk kemi dhënë në të vërtetë zbërthimin e kuptimeve të foljes, por kemi përcaktuar një kuptim të saj të prejardhur, për të sqaruar kuptimin e mbiemrit. Kështu kemi të bëjmë me një kuptim të

* Këtu dhe më poshtë fjala *veprim* përdoret në kuptimin më të gjerë për foljet, që tregojnë një veprim, të qenë, të ndodhur, etj.

16) Për shpjegimin e kësaj fjale shih *Fjalorin e gjuhës shqipe*, botim i Institutit të shkencave, Tiranë, 1954, f. 269.

dytë të mbiemrit *i lëvizshëm*, të cilin do ta shpjgojmë që *lëviz shumë*, *i gjallë*, *i shkathët*.

Në togun: *grua e lëvizshme* kemi një kuptim të tretë të mbiemrit. Ky kuptim lidhet ose me kuptimin figurativ të foljes kalimtare *lëviz*, në frazeologjizmin *lëviz bishtin*, ose me kuptimin figurativ të foljes jokalimtare *lëviz* = mbaj qëndrim të keq moral. Edhe ky kuptim ka ardhur nga kuptimi i frazeologjizmit *lëviz bishtin*, ku ka fituar përdorim dhe kuptim më vete komponenti i parë. Në dhënjen e këtij kuptimi nuk do të ishte i mjaftueshëm shpjegimi «që e lëviz bishtin», por në rradhë të parë duhet të përdoren sinonimet: e pandershme, bishtdredhur etj. Por edhe këto nuk do të mjaftonin, pa u dhënë edhe shënimi i caktuar stilistikor si fjalë e stilit bisedor. Gjithashtu ky kuptim u përket vetëm emrave të gjinisë femërore dhe s'përdoret për gjininë mashkullore.

Që të tria kuptimet e mbiemrit *i lëvizshëm* nga ana semantike kanë të përbashkët tiparin e aftësisë së kryerjes së veprimit. Ky kuptim ka zënë vend në gjuhën letrare mbas një diferencimi, që është bërë me mbiemrat pjesorë, tek të cilët ka mbetur kryesisht kuptimi rezultativ. Kështu në toskërishte mbiemri *i lëvizur* shënon edhe tiparin e aftësisë së kryerjes së veprimit, por me këtë kuptim fjala nuk ka hyrë në gjuhën letrare. Këtë e shpreh tashmë forma me *-shëm*. Brenda çerdhes fjalëformuese kemi edhe mbiemrin *lëvizës*, p.sh. *forcë lëvizëse*. Ky mbiemër shënon tiparin e vepruesit. Edhe zberthimi i tij bëhet: që *lëviz*, ku folja *lëviz* përdoret në një nga kuptimet e prejardhura të foljes kalimtare. Këtë analizë të kuptimit të mbiemrit e bëmë për të sqaruar konkretisht disa çështje të kuptimit të mbiemrave të këtij grupi dhe lidhjen semantike të tyre me kuptimin e foljes, që shërben si temë prodhuese e mbiemrave. Për të përcaktuar kuptimin e nuancat kuptimore që ka mbiemri, duhet bërë një analizë konkrete e materialit gjuhësor, për çdo njësi leksikore, si brenda çerdhes së saj në sistemin e sotëm fjalëformues, ashtu edhe në lidhjet sistemore leksikore.

II. *Grupi i mbiemrave që nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes që përbën temën prodhuese.*

Nga ana strukturore duket qartë se në temën e tyre prodhuese këta mbiemra kanë një formë të pjesores së foljes, kurse nga ana semantike, kjo është zbehur nga kuptimi foljor. Këta mbiemra shprehin tipare të një gjendjeje të caktuar dhe nuk shprehin aftësinë a mundësinë e kryerjes së një veprimi ose të nënshtrimit ndaj një veprimi.

p.sh. Mbiemri *i mrekullueshëm* ka dy kuptime:

1 — shumë i mirë: (ilaç, jetë, njeri, oreks) i mrekullueshëm.

2 — shumë i bukur: (fotografi, pamje) e mrekullueshme.

Mbiemri *i bëshëm* ka kuptimin: i shëndoshë, i mbushur, i plotë nga trupi, p.sh.: «Dhe e tëra që nga koka e ne këmba ishte e bëshme dhe e ngjeshur me një nur të rrallë. [S. Andoni, «Maleve në Shënëndre», Tiranë 1958, f.17]; «Leka aso kohe, s'ishte qenë veçse gjashtëmbëdhjetë vjeç, por me shtat të bëshëm e me fuqi luftarake, që s'e kishte shoqin», [Ndoc Nikaj, «Shkodra e rrethueme — Buku rusha» Tiranë 1961, f. 216].

Kuptimi që kanë mbiemrat *i bëshëm*, *i mrekullueshëm* është i ri, dhe lidhja e këtij kuptimi me atë të foljeve të temës së tyre është errësuar, është shkëputur. Kështu kuptimi i mbiemrit ka ardhur pasi kanë ndodhur zhvendosje të caktuara semantike, si pasojë e të cilave është fituar një kuptim i ri në krahasim me foljet *bëj* e *mrekullohem*.

Në këtë grup mbiemrash futim edhe ata, që tashmë duken qartë si dialektore ose si përdorime të rastit (okazionale) të ndonjë autori, p.sh.:

Mbiemri *i hyjnueshëm* në «Fjalorin e gjuhës shqipe» 1954 referohet

tek *hyjnor*. Fjala *hyjnor* shpjegohet: që i përket hyjit, që ka cilësinë e hyjit. Shpjegimi më i drejtë i kuptimit të këtij mbiemri, do të ishte: që i përket hyjnisë, që ka cilësinë e hyjnisë.

«Puna e organizatave të partisë me këtë kategori punonjësish, ashtu siç ka porositur vazhdimisht partia, duhet të jetë e kualifikuar, bindëse, e *durueshme*, pa i futur diskutimet në qorrsoke...». [«Zëri i popullit» 25.I.1969, f. 2]. Në këtë kontekst mbiemri *i durueshëm* ka kuptimin «me durim, që kërkon durim» dhe është larguar tashmë nga lidhja e drejtpërdrejtë me kuptimin e foljes. Kuptimi që ka mbiemri, nuk ka gjetur edhe formën e drejtë gjuhësore. Për këtë arsye ky përdorim mbetet i rastit dhe i kufizuar, meqenëse këto kuptime në gjuhë shprehen nga mbiemrat me temë emërore, duke ju shtuar prapashtesa -shëm si: *i guximshëm*. Kemi edhe fjalë popullore me shtrirje të kufizuar, që kanë një element të ri kuptimor p.sh. «Bima erdhi e *lëngueshme*» [Gosë, Lok. Lekaj, Durrës] = me lëngim.

Si mbiemra që ruajnë karakterin e tyre dialektor janë *i madhnueshëm*, *i naltuëshëm*. Këta, jo vetëm që kanë mbetur si dialektorë në gjuhën shqipe, por janë edhe forma të izoluar brenda çerdisë së tyre fjalëformuese. Ky izolim dhe humbja e lidhjes së kuptimit të tyre me foljen që shërben si temë prodhuese, i bën këta mbiemra që të mos hyjnë fare në gjuhën letrare. Këta janë kalkime nga gjuhët e tjera, p.sh. it. *maestoso* i përgjigjet shqip *i madhnueshëm*.

Në gjuhën shqipe ka disa mbiemra, të cilët motivohen nga ana semantike me lidhjen e drejtpërdrejtë të kuptimit të tyre me kuptimin e parë kryesor të foljes të temës së tyre prodhuese, p.sh. *ujë i rrjedhshëm*. Ky nuk mbetet si i vetmi kuptim që merr mbiemri. Ngjet që të ketë edhe ndonjë kuptim tjetër, i cili nuk lidhet kuptimisht drejtpërdrejt me foljen që shërben si temë e tyre prodhuese. Me shkëputjen e kësaj lidhjeje ose me mungesën tashmë të kësaj lidhjeje këta mbiemra kanë pësuar zhvendosje të tilla kuptimore, sa që shprehin tipare cilësore të tjera. Këto kuptime të tyre nuk vijnë nga kuptimet e prejardhura ose figurative të foljes, meqenëse kjo folje nuk i ka ato në strukturën e saj kuptimore. Kështu tek mbiemri kemi një realizim të një kuptimi që s'e ka folja, një zgjerim të strukturës së saj kuptimore në krahasim me foljen, kur përdoret si kategori e veçantë leksiko-gramatikore, p.sh. lojë e *rrjedhshme* = e lidhur, pa pengesa.

«Terreni i rënduar e plot baltë i pengoi futbollistët e të dyja skuadrave të zhvillonin një lojë të *rrjedhëshme*», [«Sporti popullor», 23.2.1969, f. 3].

Mbiemri *i rrjedhshëm*, që ka kuptimin «i lidhur, pa pengesa», tregon një cilësi reale që ka emri i dhënë. Ky kuptim i tij nuk motivohet me asnjë nga kuptimet e foljes *rrjedh*, por ka lindur si kalkim semantik prej gjuhëve të tjera.

Po kështu edhe mbiemri *i shkëlqyeshëm* në kuptimin e tij të parë tregon aftësinë që ka sendi i emërtuar nga emri që cilësohet, për të kryer veprimin e shprehur nga folja që shërben si temë e mbiemrit, p.sh. (dëborë, lesh, lëkurë) e *shkëlqyeshme* = që shkëlqen. Këtu kuptimi i mbiemrit lidhet drejtpërdrejt me kuptimin e parë të foljes *shkëlqej*. Por ky mbiemër ka edhe kuptime të tjera që tregojnë një shkallë të lartë të një cilësie të caktuar, p.sh. (kushte, notë, perspektivë, rezultat) *i shkëlqyeshëm* = shumë i mirë; (fitore, sukses, triumf) *i shkëlqyeshëm* = shumë i madh, i shquar; (pamje, tablo) e *shkëlqyeshme* = shumë e bukur.

Sot në gjuhën shqipe krahas formës me prapashtesën -shëm përdoret edhe mbiemri pjesor *i shkëlqyer*, i cili përveç kuptimit rezultativ shënon edhe kuptimet e mësipërme, që u dhanë për *i shkëlqyeshëm*. Prirja e përgjithshme është që mbiemrat pjesorë të mbajnë kryesisht kuptimin rezul-

tativ dhe kuptimet e tjera t'i marrë mbiemri foljor me *-shëm*. Sot ka ndodhur një diferencim në tërësi, i cili s'ka mbaruar ende.

Nga sa u tha për mbiemrat: *i rrjedhshëm*, *i shkëlqyeshëm*, përfundojmë se kur kuptimi i tyre nuk lidhet semantikisht me ndonjë kuptim të foljes përkatëse, që shërben si temë prodhuese, atëhere këta mbiemra kanë kuptime të tjera, të ndara qartë nga kuptimet e para dhe për këtë arsye, përfshihen në grupin e dytë të mbiemrave, që nuk kanë kuptimin e aftësisë e të mundësisë për kryerjen e veprimit a për t'ju nënshtruar një veprimi.

Edhe mbiemri *i çmueshëm*, kur ka kuptimin *i vyer*, *i vlefshëm*, *i rëndësishëm*, nuk i ruan lidhjet e drejtpërdrejta me foljen, p.sh. (eksperiencë, gur, gjë, vërejtje) e *çmueshme*.

Mbiemri nuk motivohet semantikisht me kuptimin e foljes, por ka fituar tipare të reja cilësore. Këto tipare të reja i ka edhe pjesorja e mbiemërsuar (adjektivuar) *i çmuar*, p.sh. (gur, ndihmë, porosi) e *çmuar*.

Në gjuhën e sotme letrare ndaj kësaj forme ka fituar epërsinë forma me *-shëm*.

Ka edhe ndonjë mbiemër i cili, duke pasur në temën prodhuese të tij temën e pjesores së foljes, nga ana semantike, nuk lidhet me kuptimin e kësaj foljeje, por me emrin e formuar prej saj, p.sh. *i paraqitshëm* = që ka paraqitje: «Mbi çadër murmuronte si i përgjumur një shi i vakët dhe pikat tinzare i spërkasinin pardesynë e gjatë, gri, të vjetëruar nga përdorimi, po prapë të paraqitëshme si çdo rrobë prej stofi të mirë, që sipas mendimit të tij, nuk vjetërohej kurrë» [Gaz. «Zëri i rinisë», 23.11.1968, f. 3].

Në grupin e dytë bëjnë pjesë edhe ata mbiemra, që janë futur në gjuhë si kalkime të fjalëve të huaja, p.sh. pasuri e *luejtshme* ose e *tundshme*, pasuri e *paluejtshme* ose e *patundshme*; ose mbiemri *i konsiderueshëm* = i madh:

«Shtimi i prodhimit të drithrave të bukës ka rëndësi të madhe ekonomike për vendin tonë, sepse kjo çon edhe në pakësimin e importit të drithit dhe në kursimin e një sasive të konsiderueshme valute që sot shpenzohet për blerjen e drithit në tregjet e tjera», [«Zëri i popullit», 5.1.1966, f. 2]; «Investimet... nuk është nevoja të kryhen menjëherë dhe të shpenzohen fonde të konsiderueshme të cilat mund të përdoren më me leverdi në investime të tjera më të nevojshme» [«Zëri i popullit», 24.2.1966, f. 2].

Për gjuhën shqipe këto raste janë shumë të rralla dhe si të tilla edhe kanë mbetur të izoluara në gjuhë.

Mbiemrat e grupit të parë jo vetëm që janë në një numër mjaft të madh në krahasim me grupin e dytë, por edhe kanë nuanca kuptimore të ndryshme. Një analizë e veçorive të tyre semantike, krahas asaj strukturorë, është e domosdoshme për zbërthimin dhe shpjegimin e drejtë të kuptimeve përkatëse. Mbiemrat foljorë në *-shëm* të grupit të parë e bëjnë cilësimin e emrit në bazë të tiparit të aftësisë a të mundësisë për kryerjen e veprimit ose të nënshtrimit ndaj veprimit. Ky kuptim, duke u motivuar me kuptimin e foljes së temës prodhuese, zbërthehet me këtë folje në një nga kuptimet e saj.

A. Mbiemrat që shënojnë tiparin e aftësisë për të kryer ose për të realizuar një veprim të caktuar.

Tipari i aftësisë për të kryer ose për të realizuar një veprim përbën semantikën e mbiemrit. Këta mbiemra kanë si temë prodhuese temën e pjesores së foljes. Midis mbiemrit dhe kuptimit të foljes së temës prodhuese

ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë. Në vartësi nga kuptimi i foljes të temës prodhuese mbiemrat i ndajmë në tre grupe:

1 — Mbiemrat që formohen nga foljet me kuptim kalimtar të diatezës veprorë.

Kuptimi i tyre zërthehet me foljen që shërben si temë prodhuese në kuptimin kalimtar të diatezës veprorë. Mbiemri karakterizon (cilëson) emrin të cilit i referohet, duke shënuar aftësinë e tij për të kryer ose realizuar një veprim. Kështu, tipari cilësor që shënojnë mbiemrat, tregon lehtësinë e kryerjes së procesit të veprimit dhe kur ky tipar mohohet (në mbiemrat me parashtesën *pa-*) tregon vështirësinë e kryerjes së procesit të veprimit. Këtu futen mbiemrat *i bezdisshëm, i çuditshëm, i habitshëm, i kënaqshëm, i mërzitshëm, i ndjeshëm* etj., që, semantikisht, do të zërthehen: që *të bezdis*, që *të çudit*, që *të habit*, që *të kënaq*, që *të mërzit*, që *ndjen* etj., p.sh.: «Në dyqan, përveç ustajt, punonte edhe kushuriri im Sasha Jakovov dhe një shitës i parë, njeri shumë i zoti, *i bezdisshëm* dhe faqekuq» [KLSH]. «Të tilla çudira, a punëra të çudiçime në kohëra të vjetëra përmendenë në historit shtatë vetëm:...» [Petro Luarasi, «Jeta dhe vepra», T, 1958, f. 187]; «Shpejtësia e lëvizjeve të tij ishte *e çudiçime*». [Fan S. Noli, «Historia e Skënderbeut», T. 1962, f. 98]; «Shkurt, pasi e humbi fare toruan, i mbiu në kokë idea më *e çudiçime* dhe më e çmendur në botë». [KLSH]. «...prodhimi i madh socialist, fuqia mbrojtëse e RP të Kinës, fryma e mrekullueshme revolucionare e popullit të madh kinez, marshojnë gjithënjë përpara me shpejtësi të *habitëshme*» [«Zëri i popullit», 7.9.1967, f. 4]; «Princët Dukagjinë dhanë shpjegime; Skënderbeu deklaroj që i gjente të *kënaqëshme*:...» [KLSH]; «Gjatë vitit të kaluar prodhimi i drithrave të bukës, me gjithë kushtet e thatësisirës, është *i kënaqshëm*» [«Zëri i popullit», 5.I.1966, f. 2]; «Sipas qëllimit artistik që ka Homeri për të ngjallur ndjenja të *kënaqëshme* e për të krijuar një gjendje të qetë shpirtërore, ai, me sa mundet, i shtëmëngjet përshkrimit të anëve jo të këndëshme të jetës shoqërore, sepse kjo do të zëmronte dëgjonjësit e tij «fisnikë», mbretërit». [Homeri, «Iliada», «Iliada dhe bota homerike», f. XXVIII; 1965]; «Në një përqindje të *kënaqëshme* është tejkaluar gjithashtu plani i vjeljes së pambukut edhe në kooperativat e Valës, Shtërmenit dhe Gostimës» [«Zëri i popullit», 4.11.1967, f. 1]; «Pjesa e dytë u bë *e mërzitëshme* për spektatorët, veçanërisht kur filluan në seri goditjet «bjeri t'i biem» të mbrojtësave, pasimet jo të sakta dhe ndërhyrjet e parregullta» [«Sporti popullor», 26.2.1963, f. 3]; «Ka prej tyre që synojnë të jenë me çdo kusht të pranishme fizikisht në çdo aktivitet të fëmijëve, t'u mbajnë atyre biseda pedagogjike moralizuese e të *mërzitëshme*, të zhvillojë çdo aktivitet ose lojë të tyre në mënyrë ushtarake. Veprime të tilla shpesh çojnë në atë që shkolla u duket kalamanëve si gazermë në kuptimin e keq të kësaj fjale». [E. Hoxha, «Të zbatojmë me këmbëngulje e në mënyrë krijuese detyrat për revolucionarizimin e partisë e të jetës së vendit, Tiranë 1968, f. 68]; «Ah!... Merrini të gjitha! S'më vjen keq për asgjë tani! — vajtoi vejusha e *ndieshme*» [KLSH]; «Megjithëse ishte *i ndieshëm* sa s'bëhej, ai shumë herë arrinte të bëhej melodramatik, por atëhere, ishte i singërtë dhe nuk e bënte për t'u dukur. [KLSH]; «Guindaçoja u shëmtua në fytyrë nga fyryja e pamerituar, që e preku «natyrën e tij të *ndijshme*» dhe me dorën e djathtë ngriti rasën gjysmë të grisur dhe mbuloi me të fytyrën, për të fshehur poshtërimin që ju bë». [KLSH]; «...në këtë rast është lehtë të hiqet një perde porsa të jetë vënë figura në fokus dhe të zëvendësohet me një tjetër, në të cilën është vendosur letra e *ndieshme* për të marrë fotografi,

kurse në rastin e parë letra e ndieshme do të vendoset në murin e kutisë së vogël». [KLSH].

Siç shihet edhe nga shembujt, kur zbërthehet kuptimi i mbiemrave që kanë në temën e tyre një folje kalimtare të diatezës veprore, krahas subjektit të veprimit kemi edhe objektin e veprimit. Ky objekt mund të jetë i shprehur gjuhësisht me një trajtë të shkurtër të përemrit ose i nënkuptuar. Kur objekti është një frymor, atëhere ai në zberthimin e kuptimit të mbiemrit shprehet me një trajtë të shkurtër të përemrit dhe kur objekti nuk është frymor ai nuk shprehet fare gjuhësisht.

2. Mbiemrat që formohen nga foljet me kuptim jokalimtar.

Kuptimi i tyre zbërthehet me foljen përkatëse jokalimtare. Folja, duke qenë jokalimtare, tregon një veprim të cilin e kryen subjekti dhe nuk kalon në një objekt tjetër. Meqenëse kemi si bazë një folje jokalimtare, në zberthimin e kuptimit të mbiemrit nuk kemi fare një objekt ku të kalojë veprimi i foljes. Këtu do të futim mbiemra të tillë si: *i kushtueshëm, i mjaftueshëm, i ndritshëm, i ndryshueshëm, i ngjashëm, i rrëshqitshëm, i rrjedhshëm, i tingëllueshëm, i vazhdueshëm, i vijueshëm* etj., të cilët zberthehen: që *kushton*, që *mjafton*, që *ndrit*, që *ndryshon*, që *ngjan*, që *rrëshqet*, që *rrjedh*, që *tingëllon*. që *vazhdon*, që *vijon* etj., p.sh.: «Aparati administrativ të bëhet më pak i kushtueshëm dhe më i manovrueshëm e operativ» [«Zëri i popullit», 4.2.1966, f. 3]; «Shirat e ditëve të fundit, që ranë në sasi të mjaftueshme e në tërë vendin, kanë krijuar kushte mjaft lehtësuese për të mbjellë shpejt e me cilësi të lartë» [«Zëri i popullit», 4.6.1968, f. 1]; «Kjo rreze elektronesh vihet në dukje lehtë me anën e lumineshencës së ndritëshme që ajo shkaktoi duke goditur mbi shumë trupa të ngurtë, për shembull, mbi qelqin e uraniumit, villemitin, sulfatin e zinkut etj.» [KLSH]; «Me një marshim solemn para tribunës kalojnë sportistët. Me gamën e përgjithshme të ngjyrave bashkohen kostumet e tyre të ndritëshme dhe fytyrat e tyre prej bronxi» [«Sporti popullor», 31.8.1960, f. 1]; «Vemjet e ritura kanë lëkurë të ndritëshme ndërsa vemjet e tri moshave të para e kanë të pa ndritëshme, janë pa qime» [KLSH]; «Beteja zhvillohej dita ditës më tepër, prandaj si mund të mësoheshin me këtë gjendje të ndryshueshme? S'ish gjë e lehtë» [KLSH]; «Në praktikë për të ndryshue frekuencën e qarkut, përdoren kondensatorët me kapacitet të ndryshueshëm (variabël) [KLSH]: «Pa shih, ai na qënkish shumë i ngjashëm me mua, dhe kjo ja kishte marrë mendjen zapties, që më kishte parë një ditë më parë». [KLSH]; «Kurse në sytë me bisht kishte diçka të rrëshqitshme» [Rev. «Nëndori», 8, 1967, f. 90]; «Duhet thënë se stafeta e kërcunjëve bëhet me shumë vështirësi, sepse kërcunjët janë të rrëshqitshëm» [«Sporti popullor», 22.12.1964, f. 4]; «Peshqit e ujrave të rrjedhshme të liqeneve malorë dhe liqeneve artificiale mbas digave që përbëjnë objekt peshkimi sportiv, janë pronë e shtetit, si pasuri e gjithë popullit» [«Gazeta zyrtare», 10, 1960, f. 286]; Pas çdo paragrafi të mallëkimit, priftërinjtë, si në kor, me zë fals, jo aq të tingëllueshëm zgjasin refrenin...» [KLSH]; «Aty luftëtari me durim dhe përpjekje, mund të mësojë ligjet bazë të rrymës së vazhdueshme dhe rrymës së ndryshueshme elektrike, magnetizmin, llojet e llambave, përbërjen e tyre dhe proceset fizike, radio-marrëset etj.» [«Luftëtari», 22.12.1960, f. 2]; «Loja e kampionëve pati ulje e ngritje dhe ata nuk qenë në gjendje t'u impononin kundërshtarëve një ritëm të lartë të vazhdueshëm». [«Sporti popullor», 5.9.1963, f. 3]; «Gruri, ashtu sikurse edhe misri, pambuku dhe kultura të tjera bujqësore, ka nevojë për shërbime kulturele, ka nevojë për një kujdes të vazhdueshëm që nga koha e

mbjelljes e deri në korrje». [«Zëri i popullit», 15.1.1959, f. 1]; «Migjeni u ngrit kundër shfrytëzimit dhe shtypjes së ashpër ekonomike e shoqërore, kundra varfërimit dhe krehdjes së *vijueshme* të popullit në mjerim [«Studime filologjike», 3, 1965, f. 136]; «I duhen njohuri shkencore njeriut që të arrijë në botëkuptimin materialist dialektik, që të kuptojë se bota, natyra apo gjithësia është një unitet të kundërtash, ajo është e pafundme dhe e fundme, e pakufishme dhe e kufishme, e përjetshme dhe e përkohshme, absolute dhe relative, e *vijueshme* dhe e ndërprershme, e pakrijueshme dhe e prejardhur» [Hulusi Hako, «Akuzojnë fenë», Tiranë, 1968, f. 12].

3. Mbiemrat e formuar nga foljet e diatezës vetvetore-mesore.

Kuptimi i këtyre mbiemrave zërthehet me foljen e diatezës vetvetore, që shërben si temë prodhuese. Mbiemri cilëson emrin, të cilit i referohet, duke shënuar aftësinë që ka ai për të kryer një veprim të caktuar. Më të shumtën këta mbiemra formohen nga foljet e diatezës vetvetore mesore, ku emri që cilësohet, është vetëm subjekt i veprimit, kurse objekt nuk ka, mbasi folja është me kuptim jokalimtar. Më të pakët janë mbiemrat që formohen nga foljet e diatezës vetvetore reciproke, ndërsa nga foljet vetvetore të mirëfillta, me sa na thonë faktet gjuhësore, nuk formohen fare. Këtu futen mbiemra të tillë si *i dukshëm*, *i lëkundshëm*, *i pajtueshëm*, *i përshtatshëm*, *i shoqërueshëm*, etj. që zërthehen që *duket*, që *lëkundet*, që *pajtohet*, që *përshtatet*, që *shoqërohet* etj. p.sh. «Me gjith atë vapë të madhe që kish pushtuar tërë gjendjen, — një lëvizje e *dukëshme* bëheshe mbi tërë fushën e gjerë të Korçës» [F. Postoli, «Për mbrojtjen e atdheut», 1926, f. 5]; «Në vende të *dukëshme* të bien në sy portrete të klasikëve të marksizëm-leninizmit, të shokut Enver Hoxha e të udhëheqësve të tjerë të partisë e të shtetit» [«Zëri i popullit», 4.2.1967, f. 1]; «Elementet e *lëkundshëm* do të forcohen, morali do të ngrihet dhe do të sigurohet kthesa» [KLSH]; «Më akuzuan si mendjemadh, gjaknxehtë, njeri pa takt, shërbëtor të borgjezisë... e të *lëkundshëm*. Jam unë i tillë?» [S. Spasse, «Afërdita përsëri në fshat», f. 179]; «Veçanërisht duhet treguar më shumë kujdes për nxënësit e dobët, të *lëkundshëm*, që kanë mbetur në ndonjë lëndë». [«Mësuesi», 24.9.1965, f. 2]; «Më vonë të tjerë na kanë këshilluar që të kufizohemi në zgjedhjen e lëndës dhe të mbajnë një ton të *pajtuarshëm* me dialektikën e kohëve». [KLSH]; «Vetëm gjatë viteve 1961-1963 janë nxjerrë jashtë përdorimit nga erozioni 3457 ha. tokë e *përshtatëshme* për drithrat e bukës». [«Zëri i popullit», 5.1.1966, f. 3]; «...njeriu që ka këtë temperament është *i shoqërueshëm*, zemër mirë, i zoti në punë,...» [F. Gega, «Psikologji», 1964, f. 183].

Nga «Fjalori i gjuhës shqipe» i vitit 1954 kemi: *i afrueshëm* (f. 3), *i futshëm* (f. 133); *i gjindshëm* (f. 157), *i ngutshëm* (f. 349, vetëm në kuptimin 2.), *i sjellshëm* (f. 434), *i shoqrueshëm* (f. 533).

B. Mbiemrat që shënojnë tiparin e aftësisë për t'ju nënshtruar një veprimi.

Këta mbiemra, që përbëjnë një rrymë të madhe fjalësh, kanë gjetur një përhapje të gjerë në gjuhë. Si temë e tyre prodhuese është pjesorja e foljeve të diatezës pësore. Nga ana semantike mbiemri ka një lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin e foljes që shërben si temë prodhuese. Tipari i aftësisë për t'ju nënshtruar një veprimi përbën semantikën e mbiemrit. Ky tipar mbetet si kryesori në këta mbiemra. Ka raste që disa prej tyre dalin me nuanca të veçanta kuptimore. Vargu i mbiemrave, që kanë kuptimin e aftësisë për t'ju nënshtruar një veprimi, është më i

madh se sa i atyre që kanë kuptimin e aftësisë për të kryer një veprim. Kjo gjë shpjegohet edhe me përdorimin më të madh të trajtave të pësore që vihet re sot në gjuhën shqipe. Krahas lindjes së foljeve pësore, që nuk kanë ekzistuar më parë, kanë dalë edhe trajtat e pësore të foljeve veprare duke marrë edhe kuptime që nuk i kanë patur¹⁶. Edhe formimet mbiemërore me prapashtesën *-shëm* janë shtuar mjaft nga foljet pësore. Kështu leksiku i gjuhës plotësohet e zgjerohet me fjalë të tjera të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore. Mbiemrat e këtij grupi karakterizojnë (cilësojnë) një emër i cili në të vërtetë është objekti i veprimit të asaj foljeje që shërben si temë prodhuese e tij dhe subjekti gjithmonë nënkuptohet. Kuptimi i veprimit që ruan tema foljore prodhuese e mbiemrit ka mundësi që të kryhet, kështu edhe mbiemri karakterizon në bazë të kësaj mundësie. Edhe zbrërthimi kuptimor i këtyre mbiemrave bëhet me foljen *mund* + foljen që shërben si temë prodhuese në pësore. Midis këtyre bëjnë pjesë mbiemrat *i asimilueshëm*, *i besueshëm*, *i djegëshëm*, *i edukueshëm*, *i kapshëm*, *i këmbjeshëm*, *i krahasueshëm*, *i kuptueshëm*, *i lexueshëm*, *i përdorshëm*, *i përkulshëm*, *i pranueshëm*, *i realizueshëm*, *i shërueshëm*, *i shijueshëm* etj. që zbrërthehen: që mund të *asimilohet*, që mund të *besohet*, që mund të *digjet*, që mund të *edukohet*, që mund të *kapet*, që mund të *këmbehet*, që mund të *krahasohet*, që mund të *kuptohet*, që mund të *lexohet*, që mund të *përdoret*, që mund të *përkulet*, që mund të *pranohet*, që mund të *realizohet*, që mund të *shërohet*, që mund të *shijohet* etj., p.sh.: «Më vonë, kur trupat e mikroorganizmave zbrërthehen në masë, azoti çlirohet në formë të asimilueshme për bimët». [«Zëri i popullit» 20.I.1966, f. 3]; «Ene gjali e deshti shumë at plakën. Nisi plaka to bo hismet t'çudiçën, t'e deshtë gjalin fort teri sa u bo plakë e besushme shumë» [Folklor shqiptar I Proza popullore, vëll. II, f. 499]; «Në kategorinë e dytë hyjnë ndërtesat që muret e jashtëme e të mbrendshme si dhe mbulesën e çatisë e kanë me material pjesërisht të *djegëshëm* dhe pjesërisht të *padjegëshëm*» [«Gazeta Zyrtare», 2, 1968, f. 31]; «Ai nisët nga besimi tek njeriu dhe tek fëmija, nga pranimit i parimit se njeriu është një qenie e *edukueshme*, e riedukueshme dhe e vetedukueshme, nga besimi në forcat e njerëzve dhe bile edhe të fëmijëve për të organizuar vetedukimin kolektiv». [«Arësimi popullor», 1, 1966, f. 52]; «Opera si gjini skenike ka për subjekt ngjarje të gëzueshme, të lehta, me melodi të *kapëshme* kollaj nga ndigjuesi». [«Ylli», 5, 1966, f. 21]; «Vetëm gjatë nëntorit rezervat e arit dhe të monedhave të *këmbjeshme* të Francës u pakësuan sa dyfishi i humbjeve të muajit tetor» [«Zëri i popullit», 15.12.1968, f. 4]; «Struktura më e mirë për organikën e një ndërmarrjeje është ajo që është nxjerrë nga studimi i strukturave të organikave të sa më shumë ndërmarrjeve të *krahasueshme* të së njejtës degë ekonomike», [«Zëri i popullit», 25.2.1966, f. 2]; «Teksti i telegrameve duhet të jetë i *kuptueshëm*». [«Ylli», 1965, 12, f. 33]; «shkrim i *lexueshëm*» [«Fjalori i gjuhës shqipe», Tiranë 1954, f. 266]; «Patëm edhe kërkesa të tjera për këtë instrument kaq të dashur dhe të *përdorshëm* në krahinën tonë». [«Mësuesi», 3.6.1966, f. 3]; «NISH — goma, fjala vjen, ka prodhuar si krehëret e *përkulshëm* për flokë ashtu edhe ata të papërkulshëm, që nuk i dallon fare nga të jashtëmit». [«Zëri i popullit», 6.1.1966, f. 1]; «Rreth saj është përqëndruar dhe vazhdon të përqëndrohet në rradhë të parë lufta midis marksistëve revolucionarë dhe renegatëve revizionistë, të cilët, kur nuk guxojnë të luftojnë hap-

16) Shih edhe Xh. Lloshi, *Gjuha dhe jeta*, Rev. «Ylli», 1, 1966, f. 10.

tas marksizmin, përpiqen t'ua përshtatin interesave të borgjezisë, ta zhveshin nga përmbajtja e tij revolucionare, ta bëjnë të pranueshëm për përfaqësuesit e të gjitha rrymave «liberale» apo «përparimtare» borgjeze. [«Zëri i popullit», 5.5.1968, f. 4]; «Unë mendoj se të gjitha fjalët në lidhje me bashkimin do të jenë fraza të zbrazëta, derisa të mos përpunohet në bazë të eksperiencës një plan i realizueshëm i këtij bashkimi» [KLSH]; «Detyrat e pesëvjeçarit të katërt do të jenë madhështore dhe njëkohësisht të vështira për t'u kryer, por plotësisht të realizueshme» [«Zëri i popullit», 5.1.1966, f. 1]; «...sëmundja e tij është e shërueshme, por duhet pohuar që doktorët... nuk e caktuan dot llojin e sëmundjes...» [KLSH]; «Çdo send i shijueshëm ka një shije të vetën të caktuar». [F. Gega, «Psikologjia», 1964, f. 27].

Në disa raste mbiemrat që shprehin tiparin e aftësisë a të mundësisë për t'ju nënshtruar një veprimi cilësojnë emra që nuk shënojnë objektin, por vendin se ku kryhet veprimi p.sh. *i peshkueshëm* = ku mund të peshkohet.; *i banueshëm* = ku mund të banohet: «...ndalohet:... c) Ndryshimi i regjimit ujqor, prerja e devijimeve të lumenjve, prerja e bimësisë dhe ndryshime të tjera të shtretërve të liqejeve dhe lumenjëve të peshkueshëm pa pëlqimin e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave». [«Gazeta Zyrtare» 9, 1967, f. 177]; «Të 400 veprat industriale, bujqësore, shoqërore e kulturore, si dhe apartamentet me një sipërfaqe të banueshme prej 1 milion e 360 mijë metrash katrore, kërkojnë përpjekje të reja nga të gjithë punonjësit dhe teknikët e ndërtimit. [«Zëri i popullit», 3.2.1962, f. 1].

Ka edhe mbiemra që marrin nuanca të tjera kuptimore si atë të meritimit për t'ju nënshtruar një veprimi të caktuar. Kështu emri karakterizohet nga një tipar, duke e merituar atë plotësisht. Edhe zberthimi i kuptimit të këtyre mbiemrave bëhet me anë të foljes *meritoj* + foljen e temës prodhuese në pësore. Këtu futen mbiemrat *i admirueshëm*, *i lavdërueshëm*, *i përbuzshëm* që semantikisht zberthehen: që meriton të admirohet, që meriton të lavdërohet, që meriton të përbuzet p.sh.: «Të gjithë njerzit që njihen për herë të parë me jetën e bletëve, hyjnë në një botë shumë interesante ose mund të thuhet fantastike për organizimin e tyre të admirueshëm, të thjeshtë, perfekt gjer në fund dhe shumë kompleks». [«Ylli», 7, 1963, f. 20]; «E kam parë Moisiun në Salsburg, duke luajtur «Jedermanın» e Hofmanstatit. Ai në këtë rol ka qenë *i admirueshëm*». [«Nëndori», 7, 1966, f. 123]; «...në këto iniciativa të lavdërueshme ka një frymëzim të madh ideologjik dhe politik, pasi ato që i marrin dhe i zbatojnë ato, shkrihen me masat, zvogëlojnë gërrshëren midis punës mendore dhe asaj fizike...» [«Zëri i popullit», 4.2.1969, f. 1]; «I tillë si ti është invalidi Nuredin Hoxha në Elbasan, i cili, megjithëse i ka gjithashtu të dy këmbët të prera, punon në mënyrë të lavdërueshme si mekanik dhe është bërë një racionalizator i shquar...» [«Zëri i popullit», 4.2.1969, f. 3]; «Por, kur themi këtë, nuk lemë në harresë një varg personazhesh të tjerë të këtij kallëpi, të cilët nënvizojnë flligëshstinë më të përbuzshme morale, pjellë dhe rrjedhim i mentalitetit mikroborgjez». [«Drita», 19.1.1969, f. 2]; «Çdo shkrimtar ka ideale të veta. Natyrisht ka gjithëfarë idealesh: ideale të larta dhe ideale të përbuzshme, ideale të drejta dhe ideale të gabuar, ideale revolucionare dhe ideale reaksionare». [«Kultura popullore» Nr. 3, 1961, f. 25];

Përveç tiparit të aftësisë për t'ju nënshtruar një veprimi mbiemrat kanë edhe nuanca të tjera si atë të domosdoshmërisë e të pashmangshmërisë, ose ka mbiemra që kanë vetëm nuancën e pashmangshmërisë për t'ju

nënshtuar veprimi, p.sh. *i dënueshëm* = *që dënohet*, *i detyrueshëm* = *që detyrohet*: «...çdo vepër e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme në të drejtën tonë penale jo vetëm nuk është një vepër shoqërisht e rrezikshme, si pasojë, e *dënueshme* nga ligja por, në të kundërt, ajo është një vepër shoqërisht e dobishme, e lejuar dhe e përkrahur prej saj». [«Drejtësia popullore», 5. 1965, f. 38]; «...çdo veprim që nuk kontribuon, por pengon thellimin e mëtejshëm të frymës revolucionare të masave në punë, është i dëmshëm dhe *i dënueshëm*». [«Zëri i popullit», 22.1.1966, f. 1]; «Që të dy ata provuan dhe një herë se kur një mbrojtës është i pregtatur mirë, ai mund të bëhet zot i situatës si në tokë ashtu edhe në ajër (me kokë) pa patur nevojë të përdorë mënyra të *dënueshme* për ndalimin e kundërshtarit». [«Sporti popullor», 2.3.1965, f. 2]; «Ne sot kemi arësim 7-vjeçar të *detyrueshëm*» [«Ylli», 5, 1963, f. 5].

Siç duket, mbiemrat në *-shëm* që formohen nga foljet e diatezës pësore shënojnë në pjesën më të madhe tiparin e aftësisë për t'ju nënshtuar një veprimi. Ky kuptim herë-herë gjendet i ndërthurur me nuancën e mundësisë. Në disa raste kjo nuancë del shumë në dukje dhe mbiemri shënon tërësisht tiparin e mundësisë për t'ju nënshtuar një veprimi. Disa mbiemra dalin edhe me nuanca të tjera si të meritimit, të domosdoshmërisë a të pashmangshmërisë së nënshtimit të një veprimi.

Mbiemrat foljorë me prapashtesën *-shëm*, që karakterizojnë në bazë të tiparit të aftësisë për kryerjen e veprimit ose të nënshtimit të një veprimi, dallohen mirë nga mbiemrat pjesorë, që kanë kryesisht kuptimin e rezultatit. Tipari rezultativ ka lindur në bazë të kryerjes së një veprimi në të kaluarën dhe si i tillë i takon planit *real* të kryerjes së veprimit. Kuptimi i mbiemrave foljorë në *-shëm* nuk lind mbi bazën e një veprimi që ngjet në të kaluarën. Tipari që shënojnë këta mbiemra ka të bëjë me planin *potencial*, d.m.th. tipari ka si bazë një veprim, i cili mund të kryhet ose e ka si aftësi subjekti që ta kryejë. Mbiemrat foljorë në *-shëm* kanë pësuar ndryshime dhe janë diferencuar semantikisht në gjuhën e sotme shqipe, ku prapashtesa ka marrë funksione të veçanta.

Tipari i aftësisë për të kryer një veprim ose i aftësisë, mundësisë për t'ju nënshtuar një veprimi shprehet, jo vetëm nga mbiemrat foljorë me prapashtesën *-shëm*, por edhe nga mbiemrat pjesorë. Këta të fundit, që janë karakteristike për toskërishten popullore¹⁷, në gjuhën e shkruar kanë dalë me dy kuptime. Njeri kuptim është ai i rezultatit dhe rrjedh drejtpërdrejtë nga folja, që shërben si temë prodhuese e mbiemrit. Me këtë kuptim mbiemrat pjesorë kanë fituar një mbizotërim, i cili është pothuajse i plotë në gjuhën e përbashkët letrare shqipe. Kuptim të tillë kanë mbiemrat i *dëshpëruar*, i *kapërdredhur*, i *këputur*, i *mallëngjyer*, i *mërzitur*, i *ngjirur*, i *pamërzitur*, i *pashkelur*, i *vdekur*, etj., të cilët zbrërthehen: që është *dëshpëruar*, që është *kapërdredhur*, që është *mallëngjyer*, që është *mërzitur*, që është *ngjirur*, që nuk është *mërzitur*, që nuk është *shkelur*, që ka *vdekur*, etj. p.sh.: «Atje tej dëgjohej hingëllimi i *dëshpëruar*, i *mallëngjyer*, i *ngjirur*, i *këputur* i një kali» [Fan S. Noli, «Historia e Skënderbeut», Tiranë 1967, f. 152]; «Ndër këmbë e ndiqte pas hieja e *kapërdredhur* e trupit» [F. Gjata, «Kënetë», Tiranë 1959, f. 222]; «Niset ky e shkon në shpi, por as *i mërzitun* as *i pamërzitun*», [«Folklor shqiptar I Proza popullore, vëllimi II, Tiranë 1963, f. 440]; «...u aratisa në këtë pyll të *pashke-*

17) Për këtë shih A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f. 85.

lur gjersa, *i dëshpëruar* rashë *i vdekur*,...» [M. Grameno, «Var'i pagëzimit», viti 1909, f. 46].

Kuptimi i dytë është ai që shënon tiparin e aftësisë për të kryer një veprim ose të aftësisë, mundësisë për t'ju nënshtuar një veprimi. Në rastet kur mbiemrat kanë prapashtesën *pa-* ky tipar mohohet. Përdorimi i mbiemrave pjesorë me këtë kuptim nuk ka gjetur shtrirje, por, përkundrazi është mënjeluar dhe kanë fituar mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm, të cilët janë specializuar semantikisht. Kuptim e përdorim të tillë kanë mbiemrat *i besuar*, *i duruar*, *i mallëngjyer*, *i pabesuar*, *i padukur*, *i paduruar*, *i pafalur*, *i paharruar*, *i pamposhtur*, *i pangopur*, *i papëlqyer*, *i pavdekur* etj., që zbërthehen: që *mund t'i besohet*, që *duron*, që *të mallëngjen*, që *nuk mund të besohet*, që *nuk duket*, që *nuk mund të durohet*, që *nuk mund të falet*, që *nuk mund të harrohet*, që *nuk mund të mposhtet*, që *nuk mund të ngopet*, që *nuk pëlqehet*, që *nuk vdes* etj. p.sh. «...kish arrirë të jetë gjenerali më i mirë dhe më i besuar i Republikës». [KLSH]; «Këtu u ndeshën njerëz kokëfortë dhe njerëz të duruar.» [«Zëri i popullit», 10.9.1967, f. 3]; «Mi këta varre të përbashkme u mblodhnë graria dhe nis në një vajtim të mallëngjyer për atë ushtëri të palumur prej trimash veterane të disa betejëve...» [Fan S. Noli, «Historia e Skënderbeut», Tiranë 1967, f. 109]; «Ç'thua, moj?! Kjo është e pabesuar — psherëtimi ai, pa i hequr sytë nga vajza» [Sh. Musaraj, «Para agimit», vëll. II, f. 90]; «Kur Nikua hyri brënda një frikë e padukur drodhi Olimbinë» [F. Postoli, «Lulja e kujtimit», Korçë 1924, f. 43]; «More ky beu u bë i paduruar: ç'i duhet tani kullë në Drithas? [S. Spasse, «Ata nuk ishin vetëm», f. 242]; «Ky ishte një gabim i pafalur për plakat, një punë e papëlqyer për të rejtat.» [V. Sejko, «Orë të vështira», f. 4]; «Ngjarje të tilla të kujtojnë legjendat e paharruara dhe sigurisht të paharruara do të mbeten» [Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka», f. 362]; «E ndjente veten të lumtur, të fuqishëm e të pamposhtur» [F. Gjata, «Në pragun e jetës», f. 131]; «Si katandisen vajzat e shkreta në këtë rrëmujë të mjegulluar, ku ujqit gjithnjë bëhen më të pangopur!» [P. Marko, «Qyteti i fundit», f. 124]; «Me latinishten elegante dhe me stilin e kujdesur fitoi këndonjës anëmbanë botës, dhe e bëri të pavdekur, kujtimin e Skënderbeut» [Fan S. Noli, «Historia e Skënderbeut», Tiranë, 1967, f. 170].

Këto dy kuptime, që janë karakteristike për mbiemrat pjesorë, në gjuhën e sotme shqipe po ndahen edhe me forma të veçanta gjuhësore. Kështu, kuptimi i parë i ka mbetur formës së pjesoreve të mbiemërara (adjektivuara). Kuptimi i dytë shprehet nga mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm. Këto diferencime formale sot duken qartë në gjuhën e shkruar, por procesi ende nuk ka përfunduar plotësisht. Kjo gjë duket, sidomos, tek ata autorë të cilët, në përdorimin e mbiemrave pjesorë, ruajnë më shumë ndikimin e dialektit tosk se sa ate të gjuhës letrare të përbashkët.

Mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm, që janë karakteristike për gegërishten, dalin me kuptime të ndryshme. Një nga këto është kuptimi rezultativ, që rrjedh drejtpërdrejt nga mbiemërsimi (adjektivimi) i pjesores. Një kuptim të tillë kanë mbiemrat *i nderueshëm*, *i pamvarshëm*, *i pëlqyeshëm*, *i qytetnueshëm*, *i rehatueshëm*, *i shëmtueshëm*, *i shtërngueshëm*, *i trishtueshëm*, *i thyeshëm*, *i urrejtshëm* etj., p.sh.: «Nji i pasun, simbas tij, asht i ndershëm, i mendshëm, i dashun, i pëlqyeshëm dhe i nderueshëm» [H. Stërmilli, «Sikur t'isha djalë», T. 1959, f. 145]; «Malsorja s'e nget. Nuk e trazon në kënaqsi të tij të pamvarshme» [Migjeni, «Novelza», 1936, f. 125]; Ushtria e juje e «qytetnueshme», [H. Mosi, «Zan'i Atdheut» Trieshte

1913. f. 86]; «Më pëlqen të mbylli sytë tue të lanë të *rehatueshme* e të lumtun me burrin tand» [KLSH]; «M'at here aj u kujtouë se njeriu i *shëmtoushëm* i paska kërkouë coucën» [Folklor shqiptar I Proza popullore, vëll. II, f. 5]; «O terr i kësaj shpellës / o hekra *t'shtërngueshme*, / Ju falem! ma t'kthellës / Ndër gropa *t'shembtueshme*, / I falem, se shqimit / Ju m'hiqni trishtimit» [N. Mjeda, «Vjersha dhe poema» T. 1953, f. 48]; «Në vendin tonë / kudo valojnë / flamujt e një melankolije / të *trishtueshme*. . .» [Migjeni, «Vargjet e lira», T. 1936, f. 112]; «Por nen te shifej nji shkamb i *thyeshëm*» [Folklor shqiptar I Proza popullore vëll. II, f. 229]; «Helena: Stonojnë kaq shumë në gojën tande këto fjalë, sa jo vetëm të bajnë qesharak, por edhe *t'urrejtshëm*» [KLSH].

Siç shihet nga shembujt, mbiemrat foljorë në *-shëm* me kuptimin e rezultatit, përdoren jo vetëm në gegërishten popullore, por edhe në shkrimtarët gegë. Edhe në gjuhën e sotme të shkruar hasen raste të tilla përdorimi, që nuk kanë vend në sistemin e gjuhës së përbashkët letrare. P.sh. «Ai qe fare i ri, me flokë të verdhë dhe me sy të vegjël e të *gëzueshëm* që i lëvizte nga të gjithë anët» [I. Kadare, «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», T. 1963, f. 115]; «Lemja i tha këto fjalë me zë të *gëzuarshëm*, po dukej se ay ishte shumë i hidhëruar.» [F. Gjata, «Ujët fle, hasmi s'fle», f. 23]; «Mjelësja kooperativiste do të niset drejt lopëve dhe do të uli e *gëzueshme* gishtin mbi një sustë» [Gaz. «Drita», 8.6.1969, f. 3]; «Që kur u bashkua me çetën, një muaj më parë, doktori ish bërë i *gëzueshëm* e i zhdërvjellët, me gjithë se qahej për ngathtësinë e tij» [Dh. Shuteriqi, «Çlirimtarët» II, f. 251]; «Po, sot, fëmijët do të derdhen të *gëzueshëm* në rrugë, në rrugët e Atdheut, që të çojnë të gjitha në shkollë» [«Zëri i popullit» 2.9.1967, f. 1]; «Shega — Nuk jam aqë e *këndueshme*. Në qoftë se ta thotë zemra duhet të ta thotë edhe goja» [Rev. «Nëndori, 6, 1966, f. 41]; «Dhe të mendosh që vitet ikin, koha shkon, — tha Roberti i *trishtueshëm* [«Nëndori» 12, 1965, f. 77]; «Realizimi i përciptë i Girlandajos nuk tërhoqi Mikelandxhelon e *mendueshëm*» («Ylli» 3, 1962, f. 25].

Një kuptim tjetër i mbiemrave foljorë në *-shëm* është ai që shënon tiparin e vepruesit. Kjo kategori në gjuhën e sotme jepet me mbiemrat foljorë me prapashtesën *-s(-ës)* dhe forma me prapashtesën *-shëm* ka mbetur si dialektore p.sh..

«Mirpo ky djali s'ishte i zoti t'punote, hate pasuninë e babës; por ishte i bujarshëm edhe i *dhonshëm*. Ku ishte molla ma i mirë ja bojshin gati ktij djali dhe ja bijshin» [Folklor shqiptar I Proza popullore, vëll. IV, f. 242]; «Po veprat t'uja aq *t'poshtnueshme*, / Nuk jan veç turp për t'gjithë Serbië» [H. Mosi, «Zani i Atdheut» Trieshtë 1913, f. 86]; «Me lot un kur kam qamun / Tue britë me *t'thershëm* zâ / Shpesh mue me m'ba me prâ» [H. Mosi, «Lulet prendvere» T. 1927, f. 43]; «Ç'acar i *therrshëm*, ç'terr i dendur» [A. Shehu, «Horizont i kaltërt», f. 56].

Karakteristikë për gjuhën popullore është edhe përdorimi i mbiemrave foljorë në *-shëm* që shënojnë tiparin e aftësisë për të kryer një veprim ose tiparin e mundësisë, pamundësisë për t'ju nënshtruar një veprimi p.sh. «Mbreti i Stambollit kishte nji pashë ç'i e mbante në Stamboll si mufettish. En ki pasha shëteëjtte në të katër anët e Stambollit e, kour sheëjfte ndonji xho të keçe ase të *çuditëshme*, ja thoshte Mbretit menjihërë» [Folklor shqiptar I Proza popullore, vëll. II, f. 10] «U tha: — U kam mbajtur pas si trima, për të *kuptuarshëm*, s'dikit gjë: mendohuni deri nesër në mëngjez dhe më nipni përgjigje...» [Folklor shqiptar I Proza popullore, vëll. III, f. 247]; «Ama kur ata po rrinin e mëndoheshin atie pranë vëretë edh'asnjë nga ata kuxonte të hynjë ndë vëretë për të gjeturë shtrofkën e asaj, vate papa

i *patrëmbëshmi* qorozi kuturisi të hynjë» [«Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar», vol. II, f. 280]; «Rregjërësja plakë, e jëma e Qirumbetit, i priti me gaz të *pathënëshëm* e s'dij si kish të nderojë më mirë mikun e hëshëm të t'birrit, për të cilin edhe zuri të ndiej shumë dashuri te zënbëra e saj.» [Folklor shqiptar I Proza popullore, vëll. IV, f. 78]; «Për një qi u dha ziarm, u ndie një gjamë e *thekshme* si gjamë burrash e u çue një tym i zi e një flakë e verdhë...» [Folklor shqiptar I Proza Popullore, vëll. II, f. 371].

Kështu në gjuhën e sotme shqipe mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm janë diferencuar në mënyrë të qartë nga ana semantike. Ata janë specializuar semantikisht duke mbajtur kuptimin që shënon tiparin e aftësisë së kryerjes së një veprimi ose të aftësisë dhe të mundësisë për t'ju nënshtruar një veprimi. Këtyre u shtohen edhe nuancat e tjera kuptimore si domosdoshmëria, pashmangshmëria dhe meritimi për t'ju nënshtruar një veprimi. Si të tillë mbiemrat foljorë në -shëm dallohen mirë nga formimet e tjera mbiemrore, por ky proces nuk ka përfunduar plotësisht. Në gjuhën e shkruar ende hasen edhe sot formime të tilla, që semantikisht e ruajnë karakterin e tyre dialektor.

Në gjuhën e shkruar vërehet edhe ndonjë rast i zgjerimit të përdorimit të mbiemrave foljorë në -shëm, duke mënjanuar mbiemra të tjerë me prapashtesën -or. Këtu futim mbiemrin i *pjellshëm*, i cili ka marrëdhënje sinonimike me mbiemrin *pjellor*. p.sh.: «Ky dhe duhet të ietë i *pjellshëm*. është i ndjenjur — tha Arifi.» [T. Laço, «Rruga e bardhë», f. 119]: «Tani atij nuk i dukej më vehtja si një dru i prerë, i vërvitur të thahej e të digjej në dhe të huaj, ajo tokë që për të qenë e *pjellëshme* për të gjithë u vadit në ato vjet me aq gjak, do ta ushqejë dhe atë çdo çast» [«Ylli» 7, 1963 f. 9]: «Pse ike o Musa efendi? — theu heshtjen Brahim. — Ti mund të rrije edhe këtu e të punonjë! Këtu tokat janë të mira, të *pjellshme*. . .» [«Drita» 2.7.1967 f. 3].

Raste të tilla sot në gjuhën shqipe janë të vecuara dhe jo aq të përgjithshme sa të mënjanojnë mbiemrat me prapashtesën -or.

Nga sa u tha më lart për mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm në gjuhën shqipe mund të nxjerrim disa përfundime:

1. — Në kategorinë e mbiemrave foljorë në -shëm pasqyrohet thyerja e kundërvënjes (opozicionit) dialektore midis dyzanoreve *ua-ue*. Në këtë kundërvënje format me *ue* zotërojnë pothuajse plotësisht në strukturën fonetike e fjalëformuese të shqipes së sotme letrare.

2. — Vetë përmbajtja dhe funksionet, që ka pjesorja në gjuhën shqipe, e bëjnë atë që të kualitativohet, «shtjellohet», jo vetëm në mbiemrat pjesorë por edhe në mbiemrat foljorë me prapashtesën -shëm.

3. — Nga pikëpamja semantiko-strukturore studimi i mbiemrave foljorë me prapashtesën -shëm mbetet për t'u vazhduar më tej. Këtë gjë e kërkon jo vetëm specializimi, zhvillimi i mëtejshëm semantik, por edhe ngulitja përfundimtare tipësore e kësaj kategorie në gjuhën letrare. Kjo kategori është specializuar kuptimisht në vijat e saj themelore, po brenda për brenda del edhe me nuancimet e saj.

4. — Në «Fjalorin e gjuhës shqipe» 1954 mbiemrat foljorë më -shëm pasqyrohen në një numër të pamjaftueshëm, duke mos u kapur as gjen-dja aktuale e shqipes, as edhe prirja e zhvillimit të saj. Mbetet si detyrë e fjalorit të ardhshëm të gjuhës së sotme shqipe, që këtë kategori fjalësh ta pasqyrojë në një mënyrë më të plotë dhe me shpjegime të sakta.

5. — Përdorimi i kësaj kategorie në stilet e ndryshme gjuhësore mbetet për vëzhgime të mëtejshme, që mund të bëhen në këtë fushë.

6. — Nga pikëpamja gjenetike, zhvillimi i kategorisë së mbiemrave foljorë me prapashtesën -shëm lidhet me zgjerimin e prirjes së shqipes drejt sintetizmit. Format analitike që + folje, që mund + folje, që meriton + folje, që duhet + folje sot po kalojnë në format sintetike të shprehjes gjuhësore, duke sjellë jo vetëm ndryshime në strukturën leksikore të shqipes, por edhe në atë gramatikore.

Mbiemrat foljorë në -shëm janë një kategori popullore me mundësi të madhe. Kjo mundësi po realizohet sot nga kërkesat, që shtron zhvillimi ekonomik-shoqëror e kulturor. Kjo kategori është zhvilluar edhe nga ndikimi i gjuhëve të tjera, si i frengjishtes, rusishtes, italishtes etj., me të cilat shqipja ka pasur dhe ka kontakte kulturore.

R é s u m é

REMARQUES SUR LES ADJECTIFS VERBAUX A SUFFIXE EN -shëm

Au point de vue sémantique et structurel les adjectifs verbaux à suffixe en -shëm n'ont pas été étudiés dans une monographie spéciale. Néanmoins, ces adjectifs ont connu quelque traitement. Les linguistes ont examiné ces formations dans les manuels scolaires, notamment au point de vue de leur structure.

Comme thème productif des adjectifs verbaux en -shëm sert le participe dans sa forme abrégée. Le contenu et les fonctions du participe en albanais font de celui-ci la seule forme admissible pour la formation des adjectifs verbaux à suffixe en -shëm. Dans notre langue le participe est la seule forme vraiment implicite du verbe. De cette forme n'est déterminée ni la modalité, ni le nombre et la personne, et même, prise en elle-même, sont assez amorphes et estompées aussi les catégories du temps et de la diathèse.

Par ce contenu aussi ample et élastique, le participe laisse à la conscience linguistique du sujet-parlant de nombreuses possibilités de réalisation. En devenant qualitatif, le participe est «décliné»; il se développe non seulement dans les adjectifs participaux mais aussi dans les participes verbaux en -shëm, où il peut avoir un sens transitif actif ou passif et un sens intransitif.

Dans l'exposé ci-contre en albanais sont traités amplement deux problèmes principaux émanant de l'analyse sémantique de catégorie des adjectifs verbaux en -shëm:

1. *La sémantique et les nuances sémantiques de ces adjectifs.*
2. *Les différenciations sémantiques intervenues dans la langue littéraire de nos jours, l'extension des acceptions et des nuances dialectales dans les formations analogues de l'albanais contemporain.*

Précédant à une analyse sémantique profonde aux adjectifs verbaux en -shëm, l'auteur distingue deux grands groupes d'adjectifs:

1. *Le groupe des adjectifs qui conservent le lien direct de sens lexical avec le verbe desservant comme thème productif.*

II. Le groupe des adjectifs qui n'ont pas un lien direct de leur sens avec le sens lexical du verbe desservant comme thème productif.

Le deuxième groupe réunit un nombre plus limité d'adjectifs, qui, dans la plupart des cas, sont fortuits ou bien n'ont qu'une extension dialectale circonscrite. Dans ce groupe rentrent aussi ces adjectifs introduits en albanais par le calque des langues étrangères.

Le premier groupe constitue la grande majorité des adjectifs. Ils sont divisés, sur la base de l'analyse de leurs particularités sémantiques, comme suit:

A. Adjectifs indiquant le trait d'aptitude à se soumettre à une action.

Un tel sens ont ces adjectifs qui sont formés par les verbes transitifs de la diathèse active, par les verbes intransitifs et par les verbes de la diathèse réflexive.

Au point de vue sémantique ce groupe se présente plus évident et sans nuances d'acception.

B. Adjectifs indiquant le trait d'aptitude à se soumettre à une action.

Ces adjectifs ont trouvé une ample diffusion en albanais. Ils ont dans leur thème productif le participe des verbes transitifs de la diathèse passive. Le trait d'aptitude à se soumettre à une action constitue la sémantique de l'adjectif. Ce trait reste le principal, mais il y a des cas où quelques adjectifs s'attribuent des nuances particulières comme celles du mérite, de l'absolument nécessaire et de l'inévitabilité à se soumettre à une action. La plus grande partie en ce groupe la constituent les adjectifs marquant le trait de la possibilité ou de l'impossibilité à se soumettre à une action.

Les adjectifs verbaux en -shëm, qui se font caractériser sur la base du trait d'aptitude à réaliser une action ou bien à se soumettre à une action, se font distinguer parfaitement des participes adjectivés, ces derniers marquant surtout le trait résultatif qui se fait jour par la réalisation d'une action dans le passé et qui a trait au plan réel de la réalisation de l'action. Le trait que marquent les adjectifs verbaux à suffixe en -shëm a affaire au plan potentiel. Le sens qu'ont les adjectifs verbaux en -shëm en albanais littéraire contemporain est le résultat d'une action sémantique. Le trait d'aptitude à réaliser une action ou de l'aptitude, de la possibilité à se soumettre à une action, est marqué aussi par les participes adjectivés, mais cela est caractéristique au dialecte tosqe parlé. Ce sens est traduit aussi dans la langue écrite, notamment par ces auteurs qui gardent davantage l'influence du dialecte tosqe plutôt que celle de la langue littéraire commune albanaise. D'autre part, les adjectifs verbaux à suffixe en -shëm en guègue populaire et écrit résultent avec le sens du trait résultatif, du trait d'agent et du trait de l'aptitude et de la possibilité. Dans la langue littéraire contemporaine albanaise le processus de différenciation a été achevé sous un double aspect. Les participes adjectivés sont spécialisés en marquant notamment le trait résultatif; au contraire, les adjectifs verbaux en -shëm sont spécialisés en marquant le trait de l'aptitude et de la possibilité. Ce processus de différenciation n'est pas encore complètement achevé, mais son avenir résulte désormais parfaitement.

La catégorie des adjectifs verbaux en -shëm doit figurer, dans le prochain dictionnaire de l'albanais, d'une façon plus complète. On doit donner plus exactement les tendances de leur développement et de leur différenciation sémantique.

Au point de vue génétique, le développement de cette catégorie se rattache à la tendance de l'albanais vers le synthétisme. Les formes analytiques që + verbe, që mund + verbe, që meriton + verbe, që duhet + verbe sont en train de passer désormais aux formes synthétiques de l'expression linguistique, en apportant non seulement des modifications dans la structure lexicale de l'albanais, mais également dans celle grammaticale.

Les adjectifs verbaux en -shëm sont une catégorie populaire de grand potentiel. Ce potentiel est réalisé actuellement par les demandes qui soulève le développement économique-scientifique et culturel. Cette catégorie s'est développée aussi sous l'influence des autres langues, comme le français, le russe, l'italien, etc., avec lesquelles l'albanais a eu et a des contacts culturels.